



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,  
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_ Prot.

Tiranë, më 14.08.2017

Lënda: Dhënie informacioni

**ZNJ. OLA MITRE  
BIRN ALBANIA**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. prot. 6950, datë 16.08.2017, me anë të së cilës kërkonti informacion në lidhje me realizimin e projekteve në fushën e turizmit në Zonën e Divjakës dhe të Nartës dh ju informojmë si vijon:

Me kërkesën e datës 25.11.2015, "MABETEX GROUP", ka shprehur interesin për të investuar në fushën e turizmit në zonën e Divjakës. Pas marrjes së kësaj kërkesë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka marrë informacion nga institucionet përkatëse në lidhje me qartësimin e statusit juridik të tokës në zonën e caktuar, me faktin nëse është zonë e mbrojtur apo jo sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002, "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar si dhe nëse ka sipërfaqe të dhëna me koncesion.

Me shkresën nr. 9223/1, datë 07.12.2015, MZHETTS, i kthen përgjigje kompanisë "MABATEX" GROUP, duke i thënë se projekti duhet të hartohet në zbatim të legjislacionit në fuqi për investimet strategjike, të legjislacionit në fuqi për turizmin, të legjislacionit për planifikimin e territorit, të legjislacionit për zonat e mbrojtura si dhe të legjislacionit për sektorin bujqësor dhe agroturistik.

Në vitin 2017, përfaqësues të MZHETTS, patën disa takime me përfaqësues të investitorëve dhe një vizite në zonën ku do të zhvillohet ky projekt. Referuar ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe VKM-së nr. 219/2015 mbi "Rregullat e procedurat për konsultimin me

grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”. shoqëria “MABETEX Tirana Sh.p.k” po përgatit raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për master planin “Resort Divjakë Albania. Bashkëlidhur gjeni:

- Kërkesë nga kompania Mabetex, datë 25.11.2015,
- Shkresë kthim përgjigje MZHETTS me nr. 9223/1, datë 07.12.2015,
- Shkresë kthim përgjigje Kryeministrit me nr.9528/1, datë24.12.2015.

Lidhur me kërkesën për leje ndërtimi për resort turistik në zonën e Nartës, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Kërkesa ka ardhur për trajtim në MZHETTS, nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), si Sekretariat Teknik i KKT-se nëpërmjet sistemit elektronik “E-Lejet”. Kjo kërkesë ka për objekt dhënien e miratimit nga ana e MZHETTS, për leje ndërtimi për objekt “Resort & SPA Turistik 1,2,3,4 kate me një kat nëntokë”, me vendndodhje Nartë, Vlorë.

Komisioni Teknik i shqyrtimit të kërkesave për lejet, ngritur me Urdhrin e Ministrit nr. 7416, datë 13.9.2016 “Për caktimin e anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin e përputhshmërisë me politikat, strategjitë dhe legjislacionin sektorial në MZHETTS, si dhe kriteret teknike të veçanta për lejet që miratohen në Këshillin Kombëtar të Territorit ose çështjet që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, mori në shqyrtim kërkesën e sipërcituar së bashku me dokumentacionin e administruar nga sistemi.

Nga studimi i fizibilitetit i paraqitur nga zhvilluesi/kerkuesi rezulon se parcela ku do të ndërtohet ky resort turistik paraqet një pronë tërësisht private, të regjistruar në emër të kërkuarit/zhvilluesit. Gjendja ekzistuese e parcelës që merret në studim paraqet një zonë të ndërtuar si një aktivitet ekonomik në vitet 70, por që aktualisht është një strukturë krejtësisht e amortizuar nga pikpamja fizike dhe funksionale. Ajo ka funksionuar si një kompleks i prodhimit të vezëve dhe mishit të pulave por që në kalimin e kohës jo vetëm që është rrënuar e nuk funksionon si e tille por në të gjitha dokumentet aktuale të zhvillimit është parashikuar të jetë një zonë me theks të përcaktuar mirë në funksion të turizmit dhe rekreacionit.

Me shkresën e saj nr. 5063 Prot, date 24.05.2017, MZHETTS i ka kthyer përgjigje AZHT-se, MZHETTS është shprehur parimisht dakort lidhur me projekt propozim, për ndërtimin e objektit “Resort & SPA Turistik 1,2,3,4 kate me një kat nëntokë”, me vendndodhje Nartë, Vlorë, sepse ky projekt synon zhvillimin turistik dhe ekonomik të zonës dhe rritjen e punësimit. Bashkëlidhur gjeni shkresën drejtuar AZHT-se, nr. 5063 Prot, date 24.05.2017.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**GENTIAN KËRI**